



Mars 2022



Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Webinari i Inovacionit i
EWA-së: Ripërdorimi
higjienik dhe i sigurt i ujit të
ndotur](#)

Online
8 Mars 2022

[LET2022 - Konferenca e 17-
të e IWA-së për teknologjitë
e ujit të pijshëm dhe ujit të
ndotur](#)

Reno, Nevada, SHBA
27 Mars - 02 Prill 2022

[Konferenca e 7-të e
Profesionistëve të Rinj të Ujit
BeNeLux 2022](#)


Delft, Hollandë
4-6 Pril 2022

[Konferenca virtuale:
Konferenca për rikuperimin
e ujit të ndotur, ujit të
pijshëm dhe burimeve](#)

Online
10-13 Pril 2022

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB organizon takimin e Palëve të Interesit mbi Letrën e Pozicionimit me temë “Përmirësimi i kornizës rregullatore për menaxhimin e aseteve (AM) në nivel vendor”



[IFAT 2022 - Panairi tregtar kryesor në botë për ujë, kanalizime, menaxhimin e mbetjeve dhe lëndëve të para](#)

Mynih, Gjermani
30 Maj – 3 Qershor 2022

[Humbjet e ujit 2022](#)

Pragë, Republika Çeke
19-22 Qershor, 2022

Në datë 17 Shkurt 2022, SHUKALB organizoi një takim virtual mbi mbi Letrën e Pozicionimit me temë “Përmirësimi i kornizës rregullore për menaxhimin e aseteve (AM) në nivel vendor”, me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të sektorit të ujit në Shqipëri. Takimi i palëve të interesit u organizua në kuadër të projektit “Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (RCDN)”.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga shoqëritë UK anëtare të SHUKALB, përfaqësues nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU), Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, Shoqata për Autonomi Vendore, si dhe RCDN – GIZ ORF MMS. Takimi u moderua nga Mihallaq Qirjo, Drejtor i Qendrës Burimore të Mjedisit, Shqipëri. [lexo më shumë](#)

Dita Botërore e Ujit, 22 mars po afron – A është shoqëria juaj gati për të festuar?



Festimi i Ditës Botërore të Ujit (DBU) është bërë një traditë për SHUKALB dhe shoqëritë ujësjetllës kanalizime anëtare të tij, si një mundësi e veçantë për të tërhequr vëmendjen dhe për të krijuar mundësinë për të nxitur qeverinë, shoqërinë civile dhe individët të ndërmarrin iniciativa të tilla ndërgjegjësimi.

Dita Botërore e Ujit është një Program i Kombeve të Bashkuara, që festohet çdo vit më 22 mars, ka për qëllim ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e ujërave të ëmbla dhe advokimin për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të ujërave të ëmbla. Çdo vit, Dita

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjetllës
Kanalizime e Shqipërisë

SHUKALB dhe SHUKOS organizojnë me sukses trajnimin Moduli Bazë i Auditit të Ujit

Gjatë datave 9 dhe 10 shkurt 2022, SHUKALB në bashkëpunim me SHUKOS organizuan me sukses online trajnimin dyditor mbi Moduli Bazë të Auditit të Ujit për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime në Shqipëri dhe Kompanitë Rajonale të Ujësjiellës në Kosovë, pjesë e Projektit “Shërbime Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve për Kompanitë e Ujit në Evropën Juglindore”.

Trajnime dhe programe të zhvillimit të kapaciteteve

SHUKALB hap regjistrimet për Trajnimet gjatë vitit 2022!



SHUKALB ka nisur tashmë Programin e Trajnimeve për vitin 2022, si pjesë e të cilit do të ofrojë një sërë tematikash për menaxhimin dhe përmirësimin e performancës së shërbimeve ujësjellës kanalizime. Këto trajnime janë të vlefshme për të gjithë profesionistët e sektorit të ujit, përfshirë stafin menaxherial të

lartë, të mesëm dhe operatorë nga shoqëritë ujësjellës kanalizime, si dhe përfaqësues nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore. Gjenerimi më shumë detaje në lidhje me regjistrimet për secilin trajnim, në Kalendarin më poshtë.

TRAJNIMET NË MARS

MBIKQYRJE


16-17 Mars 2022, Tiranë

Ky kurs trajnimi thekson rolin e mbikëqyrësit në përmbushjen e misionit dhe objektivave të shoqërive ujësjellës kanalizime. Kursi fokusohet tek aftësitë dhe njohuritë që duhet të ketë një mbikëqyrës mbi planifikimin, koordinimin dhe motivimin e punonjësve me qëllim që çdokush të punojë me efektivitet për përmbushjen e objektivave. Qëllimi kryesor i këtij kursi është që t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe teknika të vlefshme mbikëqyrje për të përmirësuar performancën e shoqërive ujësjellës kanalizime.



Ky kurs trajnimi është veçanërisht i vlefshëm për drejtuesit dhe përgjegjësit e departamentit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun. [lexo më shumë](#)


SHUKALB dhe SHUKOS organizojnë Takimin e Përbashkët Vjetor të Trajnerëve



Më 18 shkurt 2022, SHUKALB në bashkëpunim me SHUKOS organizuan online Takimin e Përbashkët Vjetor të Trajnerëve. Ky takim është një traditë e Programit të Përbashkët të Trajnimit të SHUKALB dhe SHUKOS, dhe gjithashtu u organizua në kuadër të angazhimit të të dy shoqatave në Projektin Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve (RCDN).

Në takim morën pjesë rreth 40 trajnerë nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët përfaqësonin profesionistë nga shoqëritë ujësjellës kanalizime, institucione të pushtetit qendror dhe lokal, kompani private, akademia, si dhe konsulentë të pavarur. Takimi u moderua nga Rozarta Pura, Drejtoreshë e Degës Juridike të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Durrës. [lexo më shumë](#)

SHUKALB organizon Webinar mbi Rregulloret Teknike të miratuara së fundmi për Projektimin dhe Ndërtimin e Sistemeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri



Në datë 10 Shkurt 2022, SHUKALB organizoi me sukses webinarin mbi “Rregullat Teknike të Projektimit e të Ndërtimit për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimin”, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 83, datë 10.2.2021. Objektivi i webinarit ishte informimi i profesionistëve kryesisht nga shoqëritë ujësjellës kanalizimeve, por edhe institucione të tjera, mbi këto rregullore teknike të miratuara rishtazi për sektorin e ujit në Shqipëri.

Në webinar morën pjesë 30 drejtues, inxhinierë të departamenteve teknike të shoqërive ujësjellës kanalizime Tiranë, Durrës, Shkodër, Lushnjë, Vau i Dejës, Kukës, Korçë, Gjirokastrë, Gramsh, Divjakë, Delvinë, Libohovë, si dhe përfaqësues të institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore si Enti Rregullator i Ujit dhe Bashkia Skrapar.

Webinari u drejtua nga Ing. Dritan Bratko, Administrator, Illyrian Consulting Engineers dhe komentet në fund të webinarit ishin shumë pozitive.

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë,
Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqipëri

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu